



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 102/2 prot.
2024

Tiranë, më 20. 02.

V E N D I M

Nr. 51, datë 20. 02. 2024

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën¹ nr. 5 regj., datë 18.01.2024, të Këshillit të Prindërve të klasës së 8 B të shkollës 9 vjeçare “Dora d’Istria”, në cilësinë e përfaqësuesve të nxënësve të kësaj klase, kundër Drejtores së Shkollës 9 vjeçare “Dora d’Istria”, E. H., në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore” dhe për “çdo shkak tjetër²”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në parashtrimet si dhe dokumentacionin e përcjellë pranë KMD-së nga subjekti ankues, Këshilli i Prindërve të klasës së 8 B të shkollës 9 vjeçare “Dora d’Istria”, theksohet ndër të tjera se: “Referuar problematikave të vazhdueshme gjatë gjithë vitit të kaluar mësimor 2022-2023 mes nxënësve të kësaj klase dhe mësueses së Matematikës V. C., përmes një email-i dt. 14.11.2022, Kryetari i atëhershëm i Këshillit të Prindërve të klasës sonë A. Xh., i kërkoi drejtoreshës së shkollës E. H., të merrte pjesë në një takim ajo dhe mësuese V. C., ku ne si prindër të diskutonim shqetësimet tona, në thelb të të cilave ishte paefektshmëria e orës mësimore Matematikë. Këtij email-i dhe kërkesës për takim, drejtoresha e shkollës nuk i ktheu asnjëherë përgjigje. Problemi me këtë mësuese nuk ishte vetëm i yni si klasë, por dhe i dy klasave të tjera paralele, 8 A dhe 8 C. Për ankesa të njëjta nga klasat 8 A dhe 8 C drejtoresha reagoi në kohë dhe dha zgjidhje konkrete, duke u caktuar një mësuese tjetër definitive/fikse (konkretisht mësuese M. Sh. për klasën 8 A - vitin e kaluar dhe E. Gj. për klasën 8 C- këtë vit shkollor). Prindërit dhe nxënësit e klasës sonë u trajtuan ndryshe nga dy klasat e tjera paralele, paçka se këtë problematikë e përcollëm vitin e kaluar dhe tek

¹ Plotësuar përmes e-mail-it datë 12.02.2024.

² Pa përcaktuar, shpjeguar apo dokumentuar se çfarë pretendon a justifikon ankuesi me këtë shkak.

³ Në vijim do t’i referohemi me akronimin: KMD.

Institucioni i Avokatit të Popullit, i cili doli dhe me një Rekomandim drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Fëmijëve tanë jo vetëm nuk u është caktuar ende një mësuese fikse, por dhe orari mësimor u ndryshon si dhe kur t'i teket drejtoreshës vazhdimisht.

Më datë 31.8.2023, A. Xh. përmes një email-i i bëri me dije drejtoreshës, E. H., kërkesën e prindërve për zëvendësimin e mësueses së Matematikës, V. C., por sërish pa kthim përgjigje nga ana e drejtoreshës. Në vijim, përmes një komunikimi në Whatsapp, A. Xh. i ka komunikuar drejtoreshës se nëse ajo nuk do t'a zëvendësojë këtë mësuese, ora e Matematikës do të bojkotohej nga fëmijët.

Më datë 7.9.2023, një përfaqësi e prindërve të klasës 8 B, zhvilloi një takim me drejtoreshën, E. H.. Nënkrjetarja e atëhershme e Këshillit të Prindërve të klasës 8 B, znj. Oneida Dervishaj, i vuri përpara drejtoreshës kërkesën për zëvendësimin e mësuese V. C., e firmosur nga prindër të klasës. Drejtoresha megjithëse n'a premtoi se do të mblidhte Këshillin e Mësuesve dhe do të na jepte përgjigje zyrtare pa filluar viti shkollor, sërish nuk na ktheu asnjë përgjigje. Ajo që na ofendoi më shumë si prindër ishte fakti se po atë ditë drejtoresha e pranoi kërkesën e klasës 8 C për zëvendësimin e mësuese V. C. me mësuese E. Gj., duke u kthyer përgjigje pa filluar ende viti shkollor. Në gjykimin tonë veprimet e drejtoreshës na janë dukur si hakmarrje ndaj ankesës që përcollëm vitin e kaluar shkollor, përmes mësueses kujdestare pranë AP.

Nxënësit e klasës së 8-të B janë penalizuar nga drejtoresha në zhvillimin e mësimin normal në lëndën e matematikës gjatë vitit mësimor 2023 - 2024. Në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, kësaj klase nuk i është caktuar akoma një mësuese fikse/definitive për lëndën e Matematikës, ndonëse kjo i është kërkuar për të disatën herë nga prindërit dhe mësuesja kujdestare e klasës.

Gjatë javës së parë të shkollës nuk u shënua asnjë orë matematike në orar për këtë klasë, ndryshe nga dy klasat e tjera paralele (8-ta A dhe 8-ta C) të cilat kishin të përcaktuara në orar orët e lëndës së matematikës.

Në vijim megjithëse ky problem iu bë i ditur disa herë drejtoreshës së shkollës, E. H., madje për këtë arsye janë zhvilluar edhe 2 takime me prindër nga ana e mësueses kujdestare të klasës, A. B. (dt. 22 shtator 2023 ku iu dorëzua drejtoreshës ankesa e firmosur nga prindërit dhe 13 nëntor 2023), ku e thirrur prej saj ka qenë edhe drejtoresha e shkollës, nuk u mor asnjë masë për zgjidhjen në kohë reale të këtij problemi.

Deri tani kanë hyrë me orë të limituara dhe jo rregullisht mësueset: V. C., M. Sh., E. Gj.

Për të pasqyruar qartë gjendjen e klasës së 8-B mjafton të përmendim faktin se nota mesatare vjetore e klasës për vitin e kaluar shkollor 2022 - 2023 ishte: 9 (nëntë)...

Në takimin e dt. 13 nëntor 2023, prindërit e pranishëm në takim janë ankuar dhe për faktin se mësuese M. Sh., këtë datë, ndonëse nuk është mësuese fikse e klasës 8 B ka tentuar të zhvillojë me fëmijët e klasës një test sipas planit mësimor të klasës së 8 (test i ndërmjetëm) ndonëse fëmijët e kësaj klase janë braktisur nga drejtoresha dhe mësueset e Matematikës duke mos u zhvilluar mësim normalisht, por duke hyrë kur t'u shkrepej atyre dhe drejtoreshës sa për të thënë që një herë në sa kohë hyri dikush. Mësuese M. Sh. ka dashur një dokument për efekt kontrolli dhe për t'u hedhur një vlerësim në SMIP fëmijëve, por mësim me klasën nuk ka pranuar të bëjë në vijim të vitit. Këtë e ka konfirmuar dje në takimin me prindër ku prezent ishin drejtoresha, nëndrejtoresha dhe mësuesja kujdestare.

Pyetjes së prindërve, nëse do të jetë ajo mësuesja definitive e klasës 8 B, ajo iu përgjigj negativisht. Madje realizimin e një testi nga fëmijët e quajti normal, pasi një test të tillë e kishin bërë dhe klasat 8 A, 8 C, por prindërit e pyetën: Si mund t'u bësh të njëjtin test me 2 klasat e tjera, ndërkohë që atyre u është zhvilluar mësimi normalisht dhe fëmijëve tanë jo? Mësuese M. Sh. përveçse ofendoi disa herë fëmijët e klasës 8 B (i etiketoi si fëmijë të këqinj pasi nuk kanë fare baza të njohurive matematike të klasës 8 dhe bëjnë "përr përr përr" se nuk duan të bëjnë detyrën). Po si mund edhe t'i fyesh pasi i ke cënuar në të drejtën për mësim??) Kjo mësuese komunikoi në mënyrë jo korrekte dhe me prindërit e pranishëm në takim, duke n'a thënë: pusho!!! Mos flisni ju, vetëm më dëgjoni mua!!! në fund e mbylli: - refuzoj të jap mësim në vijim me nxënësit e kësaj klase. Drejtoresha t'a gjejë zgjidhjen ne Ministri. Prindërit e pranishëm iu lutën disa herë të mos i braktiste fëmijët e kl. 8 B pasi ka kaluar shumë kohë dhe situata sa vjen e rëndohet.

Pyetjet që shtrojmë ne si prindër: Si do vlerësohen në lëndën e Matematikës këta fëmijë për periudhën e parë? - Kush do t'i vlerësojë? - Mbi ç'kriteret? - Kush do t'a hedhë këtë lëndë në SMIP?

Padiskutim, përveçse braktisje e fëmijëve, veprimet e drejtoreshës dhe mësueseve të Matematikës janë tërësisht diskriminuese dhe cënuese në raport me fëmijët e tjerë të shkollës.

Shqetësimi tjetër i yni është se 2 javët e fundit, duke dashur të bëjnë ndonjë orë mësim apo zëvendësim, pas agravimit të rëndë të situatës, si drejtoresha ashtu edhe mësueset M. Sh. dhe E. Gj. kanë cënuar zhvillimin e orëve në lëndët e tjera, konkretisht dhe biologji, frengjisht duke u marrë atyre orët e mësimi, pra duke lënë mangut dhe zhvillimin e mësimi në orët e tjera tashmë.

Gjithë sa u cituam më sipër vërtetohet lehtësisht përmes procesverbaleve të takimeve me prindër (dt. 22 shtator dhe 13 nëntor), komunikimeve në Whatsapp në grupin e prindërve të klasës 8 B.

Në kushte të tilla kur shkolla është interesi më i lartë i fëmijëve, nuk e dimë si qëndrojnë tërësisht pasive dy punonjëset e shërbimit psiko - social pranë kësaj shkolle, kur prioriteti i punës së tyre duhet të jetë respektimi i të drejtave të fëmijëve në shkollë”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit ndaj nxënësve dhe prindërve të klasës së 8 B.

Pas shqyrtimit paraprak të ankesës së depozituar pranë Komisionerit, u konstatua se ajo kishte mangësi të anës formale, në lidhje me shkakqet e pretenduara nga ana e subjektit ankues dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur, në raport me subjektin nga i cili pretendohet të jetë kryer sjellja diskriminuese.

- Për këtë arsye, nëpërmjet e-mail-it të datës 24.01.2024, KMD, i ka kërkuar subjektit ankues, të saktësojë dhe dokumentojë shkakun e pretenduar (gjendjen arsimore dhe çdo shkak tjetër) dhe të plotësojë informacionin e dokumentacionin e nevojshëm lidhur me:
- Legjitimitimin e Këshillit të Prindërve, për të depozituar ankesë pranë Komisionerit, në emër të nxënësve të klasës së 8 B.

- Sqarimin e shkaqeve të diskriminimit, si pasojë e të cilëve klasa e 8 B, është trajtuar në mënyrë të pabarabartë apo të pafavorshme në raport me klasat e 8 A dhe 8 C.
- Informacion nëse klasat e 8 A dhe 8 C, kanë paraqitur ankesë tek Avokati i Popullit, për situatën e krijuar? Kur ka ndodhur kjo? A janë paraqitur ankesat në të njëjtën kohë? Nëse po, të specifikohet periudha e ankesave të bëra edhe masat e marra nga ana e shkollës "Dora d'Istria", për plotësimin me mësues.

Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, nga komunikimi nëpërmjet postës elektronike, subjekti ankues, me shkresën⁴ datë 30.01.2024 dhe e-mail-in datë 12.02.2024, vuri në dispozicion të Komisionerit dokumentacionin si më poshtë:

- Prokurë të Posaçme për përfaqësimin e nxënësve të klasës së 8 B nga ana e Këshillit të Prindërve të kësaj klase;
- Ankesat drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Avokatit të Popullit dhe Drejtores së Shkollës "Dora d'Istria".

Sa i përket shkaqeve të diskriminimit, subjekti ankues me anë të shkresës datë 30.01.2024 dhe e-mail-it datë 12.02.2024 theksoi se: **"Gjendja arsimore: Veprimet dhe mosveprimet e drejtoreshës për zhvillimin e një procesi të rregullt mësimor në lëndën e Matematikës ka ndikuar drejtpërdrejtë në formimin e këtyre nxënësve duke mbetur mbrapa me bashkëmoshatarët e tyre në klasat paralele 8 A dhe 8 C në të njëjtën shkollë.**

Çdo shkak tjetër:

1. Qendrimet joprofesionale dhe arrogante ndaj shqetësimeve tona si prindër, kujdestar ligjor të fëmijëve, të cilat janë në kundërshtim të hapur dhe flagrant me parimet për mbrojtjen e të drejtave të nxënësve, përgjatë kohës që ata gjenden në ambientet e shkollës.
2. Mos zbatimi i udhëzimeve, rekomandimeve të organeve të tjera publike, për garantimin e të drejtave të fëmijëve/nxënës dhe përmirësimin e klimës edukative në institucionin arsimor shkolla 9-vjeçare "Dora d'Istria" Tiranë, të cilën ajo është drejtuese.
3. Për shkak të moszgjidhjes së problematikës në lëndën Matematikë me klasën e 8 B, me 14.11.2023, është dërguar një ankesë pranë MAS dhe AP...".

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, përcaktohet se: "Ky ligj rregullon zbatimin dhe dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër".

⁴ Protokolluar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me nr. 102/1 prot., datë 30.01.2024.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përvajshim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se viktimat e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, është përcaktuar si shkak diskriminimi “çdo shkak tjetër”. Subjekti ankues në rastin në fjalë nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike.

Dokumentimi i tyre është thelbësor në çështjen e provimit të “shkakut” për të cilin subjekti ankues pretendon se si pasojë e posedimit të tij i kanë ardhur më pas të gjitha pasojat e pretenduara. Në rastin e mosprovimit e mosdokumentimit të “shkakut”, nuk mund të dilet në përfundimin se paligjshmëritë e pretenduara nga subjekti ankues lidhen pikërisht me këto “shkaqe”.

Në këtë kontekst, Komisioneri për të vlerësuar nëse pretendimet e subjektit ankues për trajtim të pabarabartë apo të padrejtë e të pafavorshëm të nënësve të klasës së 8 B të shkollës 9-vjeçare “Dora d’Istria”, vijonë për shkaqet e pretenduara, duhet që fillimisht këto shkaqe të jenë provuar e dokumentuar para KMD-së, si shkaqe të njohura nga LMD.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim, Komisioneri vlerëson se, personi ose grupi i personave⁵ të cilët pretendojnë se janë diskriminuar për këto shkaqe, por jo vetëm, duhet gjithashtu të parashtrojë fakte nga të cilat mund të vlerësohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkaqet e mbrojtura, që në çështjen objekt shqyrtimi paraprak, janë: gjendja arsimore dhe “çdo shkak tjetër”.

⁵ Grupi i nxënësve të klasës së 8 B të shkollës 9-vjeçare “Dora d’Istria”, Tiranë.

Së pari, sa i takon pretendimit të subjektit ankues⁶ për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, i pa dokumentuar dhe i paprovuar, Komisioneri vlerëson se nuk qëndron, pasi ai nuk është “shkaku” në vetvete.

LMD, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë të hapur shkaqesh⁷. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh⁸.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar staturë të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Diskriminimi⁹ karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të

⁶ Grupi i nxënësve të klasës së 8 B të shkollës 9-vjeçare “Dora d’Istria”, Tiranë.

⁷ Neni 1, i ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar citon se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”

⁸ Neni 14, I KEDNJ-së: “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër*”.

një karakteristike të tij që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën subjekti ankues nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Lidhur me çdo shkak tjetër, subjekti ankues argumentoi ndër të tjera se:

- *Qendrimet joprofesionale dhe arrogante ndaj shqetësimeve tona si prindër, kujdestar ligjor të fëmijëve, të cilat janë në kundërshtim të hapur dhe flagrant me parimet për mbrojtjen e të drejtave të nxënësve, përgjatë kohës që ata gjenden në ambientet e shkollës.*
- *Mos zbatimi i udhëzimeve, rekomandimeve të organeve të tjera publike, për garantimin e të drejtave të fëmijëve/nxënës dhe përmirësimin e klimës edukative në institucionin arsimor shkolla 9-vjeçare “Dora d’Istria” Tiranë, të cilën ajo është drejtuese.*
- *Për shkak të moszgjdhjes së problematikës në lëndën Matematikë me klasën e 8 B, me 14.11.2023, është dërguar një ankesë pranë MAS dhe AP...”.*

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike të grupit të personave që ata përfaqësojnë, por referojnë si shkak pasojat që kanë ardhur si rezultat i moszbatimit të akteve ligjore apo nënligjore në fuqi. Sakaq, këto pretendime nuk lidhen me shkakun, cilësinë e veçantë apo ndonjë karakteristikë individuale specifike të grupit të personave që ata përfaqësojnë. Gjithashtu, fakti që ata i janë drejtuar me ankesë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit apo Avokatit të Popullit pasi ka ndodhur trajtimi i pabarabartë i pretenduar, nuk përbën në vetvete një shkak për të cilin ka ardhur si pasojë mos zëvendësimi i mësueses së lëndës së Matematikës për klasën e 8 B të shkollës “Dora d’Istria”.

Komisioneri vlerëson se, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese në radhë të parë duhet të provojë se, shkakun i pretenduar është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit, dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasje gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak. Megjithatë, vetëm identifikimi i një ose më shumë shkaqeve, të cilat mbrohen në mënyrë të shprehur nga ligji, nuk është e mjaftueshme për të ngritur një pretendim për diskriminim. Personi apo grupi i personave i cili pretendon se është diskriminuar për një ose më shumë se një nga shkaqet e mbrojtura, duhet të parashtrojë fakte nga të cilat mund të prezumohet se ka një diferencë në trajtim dhe se kjo diferencë në trajtim pretendohet se ka si bazë shkakun ose shkaqet e mbrojtura.

Pra, në bazë të rrethanave të shpjeguara nga subjekti ankues lidhur me pretendimin për diskriminim për “çdo shkak tjetër”, nuk ka informacion të mjaftueshëm që të lejojë shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

⁹ “Diskriminimi” përkufizohet nga ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Së dyti, subjekti ankues, në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, pretendon diskriminimin për shkak të gjendjes arsimore duke e lidhur me veprimet dhe mosveprimet e drejtoreshës sa i përket mosplotësimin të kërkesave të tyre për zëvendësimin e mësueses së lëndës së Matematikës për klasën e 8 B të shkollës “Dora d’Istria”.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit, kufizimit, përjashtimit ose preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit. Gjithashtu, jo çdo diferencë në trajtim është diskriminim, por vetëm ato që nuk kanë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Pra, nëse për diferencën në trajtim konstatohet se ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, atëherë trajtimi ndryshe është i përligjur dhe nuk është i ndaluar nga ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në mënyrë të shprehur në lidhje me shkakun e gjendjes arsimore, të pretenduar nga subjekti ankues si arsyeja ose shkakun për të cilën ai i është nënshtruar një trajtimi të diferencuar dhe të disfavorshëm.

Komisioneri vlerëson se, *gjendja arsimore si shkak diskriminimi*, nënkupton diferencën në trajtim dhe trajtimin më pak të favorshëm që një person apo grup personash i nënshtrohen për shkak të nivelit individual të arsimimit, çertifikatave ose diplomave që personi apo grupi i personave posedojnë.

Duke mbajtur në konsideratë standardet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues ka ngritur pretendime për trajtim të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e subjektit kundër të cilit ka paraqitur ankesën pranë KMD-së, Drejtoresha e shkollës “Dora d’Istria”, duke pretenduar se është gjendur në një situatë diskriminuese, situatë e cila supozohet se ka si shkak gjendjen arsimore, të cilën e lidhin me shpjegimin se: *“veprimet dhe mosveprimet e drejtoreshës për zhvillimin e një procesi të rregullt mësimor në lëndën e Matematikës, kanë ndikuar drejtpërdrejtë në formimin e këtyre nxënësve duke mbetur mbrapa me bashkëmohatarët e tyre në klasat paralele 8 A dhe 8 C në të njëjtën shkollë”*.

Në informacionin e përcjellë nga subjekti ankues pranë Komisionerit, nuk ka paraqitur asnjë dokument apo provë, për të vërtetuar se diskriminimi i pretenduar ka ndodhur si pasojë e ndonjë karakteristike individuale specifike të grupit të personave që ata përfaqësojnë, por referojnë si shkak pasojat që kanë ardhur si rezultat i veprimeve dhe mosveprimeve të drejtoreshës shkollës “Dora d’Istria”, për zhvillimin e një procesi të rregullt mësimor në lëndën e Matematikës, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejtë në formimin e këtyre nxënësve duke mbetur mbrapa me bashkëmohatarët e tyre në klasat paralele 8 A dhe 8 C në të njëjtën shkollë.

Lidhur me sa më lart, si dhe me shpjegimet që jep subjekti ankues mbi shkakun e pretenduar, Komisioneri, vlerëson se, ai nuk përbën në vetvete shkakun e diskriminimit të pretenduar, atë të gjendjes arsimore, por ka të bëjë me pasojat që i kanë ardhur nxënësve të klasës së 8 B, si rezultat i mos marrjes në konsideratë e kërkesave të tyre për zëvendësimin e mësueses së lëndës së Matematikës. Pra, gjendja arsimore e subjektit ankues, duke referuar veprimet dhe mosveprimet e drejtoreshës së shkollës, nuk rezultojnë që të jetë arsyeja apo shkakun i trajtimit të pabarabartë nga ana e subjektit kundrejt të cilit drejtohet ankesa.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi i subjektit ankuesi për diskriminim për shkak të “gjendjes arsimore” dhe “çdo shkak tjetër”, sipas kuptimit të LMD-së, nuk rezultojnë i provuar bazuar në provat e depozituara prej tij.

Pala ankuese nuk parashtron e argumenton bindshëm me fakte e prova, se mbart shkaqet e pretenduara, mbi të cilat të mund të vijohej me hetimin e ankesës, nëse grupi i nxënësve që ata përfaqësojnë është trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të diferencuar nga ana e Drejtoreshës së shkollës “Dora d’Istria”, lidhur me zëvendësimin e mësueses së lëndës së Matematikës për klasën e 8 B, trajtim i cili të jetë motivuar pikërisht nga gjendja arsimore dhe çdo shkak tjetër.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se:

“4. Ankesa nuk pranohet nëse:ç)nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së subjektit ankues, Këshilli i Prindërve të klasës së 8 B të shkollës 9 vjeçare “Dora d’Istria”, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Gjendja arsimore dhe çdo shkak tjetër)
(Fusha: Arsim)